

ENVER BYTYÇI

DIPLOMACIA IMPONUERE E NATO-S NË KOSOVË

Kjo temë është bërë objekt studimi dhe diskutimi gjithpërfshirës jo vetëm në hapësirën shqiptare e ballkanike, por edhe në përmasat europiane e botërore. Në themel të këtij diskutimi kundërthënës gjendet përgjigja rreth kundërthënies, veçmas lidhur me legjitimitetin e ndërhyrjes së NATO-s dhe sulmeve të saj kundër Jugosllavisë (Serbisë). Ndërkaq nuk mund të pritet një përgjigje e pakontestueshme. Por burimet e shumta të këtyre diskutimeve plotësojnë atë mozaik qëndrimesh e këndvështrimesh të këtij procesi ballafaquar gjithnjë me teorinë e të drejtës ndërkombëtare.

E drejta ndërkombëtare nuk fikson norma dhe rregulla të sjelljes midis shteteve dhe organizmave njësoj siç ato fiksohen në ligjet e normimit të sjelljes njerëzore në kuadër të së drejtës shtetërore. Sistemi juridik ndërkombëtar shpesh herë nuk pasqyron prirjet e zhvillimit global. Kjo ndodh për shkak të përpjekjeve të fuqive vendimarrëse për të gjetur ekuilibra dhe pajtueshmëri midis tyre, si dhe për shkak të fleksibilitetit më të madh të sjelljes ndërkombëtare në raport me sjelljen e një shoqërie kombëtare ose shtetërore. Për këto arsye diplomacia dhe ndërhyrja e NATO-s në konfliktin e Kosovës qartësohet, zbardhet dhe ndriçohet kryesisht nga ballafaqimi i pikëpamjeve të kundërta dhe ideve e praktikave konkrete të sjelljes ndërkombëtare.

Nisur nga ky model interpretimi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e Hagës në vendimin e saj të datës 22 korrik 2010 arriti në përfundimin se shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ishte në pajtim të plotë me të drejtën ndërkombëtare dhe se ajo nuk e cënon rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të 10 qershorit 1999, përmes së cilës Kosova u vu nën administrimin ndërkombëtar.¹ Pas këtij

¹ Stefan Kornelius, *IGH-Entscheidung zum Kosovo-Recht auf Freiheit* - "Für den Freiheitswunsch eines Volkes gibt es keine Grenzen, auch keine rechtlichen. Ein heterogener Staat kann auf Dauer nicht mit Gewalt zusammen gehalten werden. Umgekehrt lässt sich der Freiheitswunsch aber auch nur erfüllen, wenn es die Machtverhältnisse zulassen. Die kollabierende Sowjetunion konnte die Staaten an ihrem Rand nicht halten. In China schaut die Zentralregierung mit Argwohn auf

vendimi të kërkuar nga qeveria e Serbisë interpretimet juridike të diskutueshme e kanë përforcuar pikëpamjen e shumicës dërmuese të studiuesve europianë dhe amerikanë, sipas të cilëve ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ishte e legjitimuar nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare.

Studimi dhe arsyetimi i legjitimitetit të ndërhyrjes së Aleancës në Kosovë do të ishin të mangët pa njohur disa të vërteta historike dhe aktuale, të cilat lidhen me shqiptarët dhe me Kosovën. Ndaj ndryshe nga ekspertët e së drejtës ndërkombëtare, historianët i shkojnë në thelb konfliktit shqiptaro-serb, duke krijuar një panoramë dhe përceptim më të mirë të asaj çfarë ka ndodhur gjatë një shekulli në Kosovë erdhën në kohën e duhur në përfundimin se moszgjidhja e konfliktit të do të krijonte një destabilitet të madh në rajon në Europë.

Mësimet historike të sjelljes së Serbisë në Kosovë, doktrinën dhe dokumentet programore të shtetit, të shkencës dhe të kishës serbe për asgjësimin e elementit shqiptar në këtë vend dhe serbizimin e shqiptarëve dhe aksionet që Beogradi ka bërë për këtë janë bërë objekt studimi të gjithanshëm dhe janë trajtuar si një përvojë e hidhur dhe e shëmtuar e realitetit në marrëdhëniet shqiptaro-serbe. Me qëllim që t'i jepet përgjigje dilemave, pyetjeve dhe pikëpyetjeve të shumta rreth konfliktit në Kosovë dhe angazhimit të Aleancës Politiko-Ushtarake të NATO-s është e domozdoshme të njihen rrënjët e konfliktit shqiptaro-serb.

Rrënjët e konfliktit shqiptaro-serb

Formimi i kombeve në Ballkan është shoqëruar me një dukuri të pazakontë. Popujt ballkanikë u organizuan në shoqërinë moderne të shteteve –komb duke u orientuar nga aleanca të kundërta e të ndryshme prej njëri-tjetrit. Popujt sllavë dhe me besim fetar ortodoks u orientuan drejt San Peterburgut e Moskës dhe gjetën tek Rusia aleatën, përkrahësen e mbrojtësen ideale për realizimin e interesave kombëtare përkatëse të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe më gjerë deri te Greqia. Këto lidhje u krijuan shumë kohë para se të krijoheshin shetet-kombe të Ballkanit, të cilat qenë pjesë e Perandorisë Osmane. Sipas historianit gjerman Michael

die vielen Volksgruppen, die nach mehr Autonomie dürsten, jeder Wunsch nach Sezession wird in einem speziellen Klima genährt. Ein Gericht kann keinen Rahmen setzen für den legalen Weg zur Abspaltung.

<http://www.sueddeutsche.de/politik/igh-entscheidung-zum-kosovo-recht-auf-freiheit-1.978519>.

Weithmann carët dhe carinat ruse në shekullin e 18-të u thirrën në ndjenjën historike me qëllim që të çlironin popujt sllavë dhe ortodoksë nga sundimi i muslimanëve dhe t'i mbronin ata nga influenca latine.²

Ndërkaq Weithmann shkruan se në Rusinë cariste pansllavizmi u shndërrua në një lëvizje politike dhe doktrinë për bashkimin e të gjithë popujve sllavë në një shtet ose në një aleancë të përbashkët.³ Beogradi e zhvilloi politikën e tij në një linjë me vijën politike të Rusisë, duke e trajtuar muslimanizmin si një rrezik permanent dhe Perendimin si pengesë për ekspansionin e saj në Ballkan e më tej. Në këtë linjë u zhvillua gjithashtu nacionalizmi shqiptar i kohës, i cili përcaktoi se sllavët dhe grekët ishin rrezik të kombit shqiptar. Prej kësaj lindi konflikti shqiptaro-serb, një konflikt me rrënjë të thella dhe me një përmbajtje të qartë dalluese në strategjinë, tiparet, qëndrimet, politikat dhe programet e të dy kombeve.

Fryma e konfliktit kishte ekzistuar edhe në mesjetë, por ajo u ringjall në kohën e Luftës Ruso-Turke të vitit 1876-1877, kur Serbia shpërnguli me dhunë nga trojet e veta me dhjetra mijë shqiptarë të Nishit, Vranjës, Toplicës etj. Aksioni serb për asgjësimin e shqiptarëve në këtë pjesë të territorit shërbeu si një sinjal i mjaftueshëm që këta të fundit të organizoheshin në mbrojtje të ekspansionit dhe rrezikut ekzistencial të tyre.⁴ Në këto kushte lindi nevoja e një lëvizjeje të fuqishme politike dhe falë angazhimit të patriotëve të shquar të kombit, si Ymer Prizreni, Sulejman Vokshi, Abdyl Frashëri dhe të tjerëve u krijuar dhe u zhvillua Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Ndërsa Lidhja e Prizrenit u mbledh më 10 qershor 1878 dhe miratoi programin e saj kombëtar të krijimit të shtetit shqiptar në territoret e katër vilajeteve, përkatësisht Kosovës (Shkupit), Manastirit, Janinës dhe Shkodrës, në Berlin u mbledhën Fuqitë e Mëdha dhe vendosën copëtimin e trojeve shqiptare në favor të fqinjëve tanë armiqësorë. Kjo bëri që konflikti të thellohej, megjithëse në programin e

² Michael Weithmann, *Krisenherd Balkan - Ursprünge und Hintergründe des aktuellen Konflikts*, Wilhelm Heyne Verlag, München: 1992, Seite 46. "Zaren (und zarinnen) fühlen sich geschichtlich berufen, die orthodoxen Balkanvölker sowohl von der herrschaft der Muslime zu befreien als sie auch vor dem Einfluss der "Lateiner" schützen".

³ *Po aty*.

⁴ Konrad Clewing, Oliver Jens Schmidt, *Geschichte Südosteuropas - Vom frühen Mittelalter bis zur Gegenwart*, Verlag Fridrich Pustet, Regensburg: 2011, Seite 455.

Lidhjes thuhej se "Ne dëshirojmë më gjithë zemër të jetojmë në paqe me të gjithë fqinjët tanë, Serbinë, Malin e Zi, Greqinë dhe Bullgarinë... Ne duam dhe nuk kërkojmë asgjë prej tyre, por jemi krejt të vendosur të mbrojmë atë që është e jona".⁵

Ndërkaq shtetet ballkanike nuk i ndërprejnë përpjekjet e tyre për asgjësimin e kombit shqiptar. Kulmi i konfliktit arriti gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Ballkanike, kur katër shtetet ballkanike sllave e ortodokse, Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria, në emër të luftës kundër Perandorisë Osmane në agoni, u sulën dhe masakruan pa mëshirë se paku 25-30 mijë shqiptarë në veri e në jug të vendit, me qëllim ndarjen e territoreve shqiptare midis tyre.⁶ Aleanca e katër vendeve ballkanike për copëtimin e territoreve shqiptare dhe moslejimin e krijimit të shtetit shqiptar ishte dëshmia më domethënëse e një realiteti trishtues për kombin tonë. Kjo aleancë funksionoi gati perfekt gjatë gjithë periudhës së shekullit të XX, duke aplikuar politika tipike genocidale në luftën kundër shqiptarëve. Kjo ndodhi gjithashtu ndërmjet dy luftrave botërore, si dhe pas Luftës së Dytë Botërore dhe e njëjta histori u përsërit në Kosovë gjatë gjithë periudhës, deri në qershorin e vitit 1999.

Ndër planet dhe programet serbe të asgjësimit të shqiptarëve mund të veçohen programi i vitit 1843 i Ilia Garashanin, i emërtuar si "Naçertania", libri i ish-kryeministrit të Serbisë, Vlladan Gjergjeviç, botuar në vitin 1913, "Shqiptarët dhe Fuqitë e Mëdha", programi i akademikut Cvijiç i fillimit të shekullit XX, diskursi politik i kryeministrit Nikolla Pashiç, memorandumit i 7 marsit 1936 dhe i vitit 1943 i akademikut Vasa Cubrilloviç, platforma e shkrimtarit Ivo Andriç dhe deri te memorandumit i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Serbisë i vitit 1986, programi shfarosës i ish-zv. Kryeministrit të Jugosllavisë (Serbisë) Vojislav Shejshel 1995, memorandumit i vitit 2003 i Sinodit të Kishës Ortodokse të Serbisë, memorandumet dhe programet antishqiptare të shoqatës serbe të gazetarëve, të shoqatës së shkrimtarëve, ose projekti i qeverisë së Serbisë dhe shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Serbe i janarit 1999 për asgjësimin e dëbimin e shqiptarëve si dhe

⁵ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Tiranë: Shtypshkronja "Mihal Duri", 1978, f. 19.

⁶ Alesander Leo Freundlich, *Albanien Golgatha - Angeklagten gegen die Vernichter des Albanervolkes*, Wien: 1913, Seite 16.

serbizimin e Kosovës.⁷ Janë të mjaftueshme këto dokumente, për të provuar faktin se Serbia u soll me racizëm kundër shqiptarëve dhe për asgjësimin e tyre mobilizoi shumicën dërmuese të serbëve.

Në konfliktin e fundit shqiptaro-serb të viteve 1990 bota e qytetëruar iu rikthye historisë së konfliktit shqiptaro-serb e sidomos elaborimeve antishqiptare të shtetit, kishës, akademisë së shkencave dhe elitës intelektuale e studentore të Serbisë kundër shqiptarëve. Më së shumti u angazhuan në këto studime dhe hulumtime ekspertët politikë dhe ushtarakë të Aleancës Politiko-Ushtarake të Atlantikut të Veriut si dhe studiues të së drejtës ndërkombëtare, ekspertë të vatrave të krizave, historianë dhe akademikë, institute dhe qendra të shumta studimore.

Regjimi i Beogradit, sidomos pas ardhjes në pushtet të Milosheviçit më 1987, dëshmoi në praktikë se i përmbahej doktrinës së krijimit të Serbisë së Madhe përmes asgjësimit të shqiptarëve dhe serbizimin e Kosovës. Heqja e autonomisë ishte hapi i parë i aksionit antishqiptar të Serbisë. Që prej 23 marsit të vitit 1989 Kosova u shndërrua de facto në koloni serbe. Autonomia e Kosovës u hoq me dhunën e policisë e të ushtrisë, madje në mënyrë arbitrarë dhe në kundërshtim me ligjet kushtetuese. Sipas liderit shpirtëror të Serbisë, akademikut, Dobrica Qosiç, fati i Kosovës ishte një çeshtje jete a vdekje për të gjithë kombin serb".⁸

Kështu mbi 115 mijë shqiptarë u përjashtuan nga puna. U mbyll televizioni dhe gazetat e shtëpia botuese, universiteti dhe shkollat e të gjitha niveleve në gjuhën shqipe. Administrata shqiptare, policia shqiptare, gjyqësia e gjithçka tjetër u zevendësuan me administratorë, policë dhe gjyqtarë serbë. U mbyllën spitalet, madje u provokuan mjete të dhunëshme, si helmimi i nxënësve, vrasja e ushtaravë shqiptarë që shërbenin në armatën jugosllave etj. Prej këtij momenti kriza dhe konflikti morën përmasa të jashtëzakonshme.⁹

⁷ Shih për këtë librin e autorit Enver Bytyçi, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, Tiranë: "Koha", 2005, në pjesën "Tipi shovinist i nacionalizmit serb", f. 16-31. Shih gjithashtu: <http://www.top-channel.tv/artikull.php?i=226536&ref=fp>.

⁸ Ree Faueert, "Das Schicksal des Kosovo ist eine Lebensfrage für die gesamte serbische Nation", in *Das Kosovo: Eine völkerrechtliche Studie*, Wien: 1999, f. 35.

⁹ *From autonomy to colonization: Human rights in Kosovo 1989-1993*, Hg. International Helsinki for Human Rights, nëntor 1993, f. 8.

Kundërveprimi i shqiptarëve të Kosovës

Shqiptarët u organizuan, me qëllim mbrojtjen e identitetit si dhe të lirive nacionale e njerëzore. Baza e organizimit shërbeu Lidhja e Shkrimtarëve dhe Aristëve të Kosovës e kryesuar nga intelektualit i shquar dhe kurajoz, Ibrahim Rugova. Lidhja shihej që prej vitit 1987 si alternativa e vetme e shqiptarëve. Veprimtaria e saj u hap dhe i kundërvu të gjitha aksioneve politike e policeske të Serbisë kundër shqiptarëve në Kosovë. Prej 23 dhjetorit 1989 në Kosovë lëvizjen politike e kombëtare të shqiptarëve e udhëhoqi Lidhja Demokratike e Kosovës e themeluar dhe kryesuar nga Dr. Ibrahim Rugova. Nën drejtimin e saj shqiptarët hodhën hapa të rëndësishëm në mbrojtje të lirive dhe të drejtave demokratike si dhe të identitetit të tyre kombëtar. Si kundërpërgjigje e heqjes me dhunë të autonomisë, më 2 korrik 1990 delegatët e Kuvendit të Kosovës e shpallën Kosovën Republikë ose, siç thuhej në Deklaratë, njësi konstituive të Federatës (Konfederatës). Të njëjtët delegatë të Kuvendit të Kosovës miratuan më 7 shtator 1990 Kushtetutën e parë Demokratike të Republikës së Pavarur të Kosovës, një kushtetutë moderne, të cilën mund ta merrnin për model të gjitha vendet e lindjes ish-komuniste, që aso kohe po rindërtonin shoqëritë dhe shtetet demokratike.¹⁰ Kosova konstitui me zgjedhje të drejtpërdrejta Kuvendin e ri të saj, si dhe presidentin të zgjedhur më 24 maj 1992. Presidenti i parë i Kosovës u zgjodh lideri politik i shqiptarëve, Ibrahim Rugova. Prej këtij momenti në Kosovë u ndërtua një shoqëri demokratike paralele, me institucionet e veta si parlamenti, qeveria në egzil, presidenti etj. Sistemi arësimor, shëndetësor, sistemi i taksave dhe gjithçka tjetër u organizua në pavarësi të plotë nga sistemi jolegjitim dhe i dhunshëm i Serbisë në Kosovë. Shqiptarët ruajtën harmoninë politike dhe refuzuan të bëhen pjesë e sistemit politik të Serbisë, gjë që i dëshmoi botës demokratike se ata ishin të vendosur në rrugën e lirisë, demokracisë e pavarësisë. Orientimi politik i liderëve shqiptarë të Kosovës dhe institucioneve që ata drejtonin ishte perendimi, aleanca me Europën dhe miqësia e përjetshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.¹¹ Por thirrjet e shqiptarëve, përfaqësuar nga lideri historik, Ibrahim Rugova, nuk u dëgjuan në Perendim. Ndonëse në Shtetet e Bashkuara gjeti mirëkuptim opsioni i pavarësisë dhe rruga e

¹⁰ Enver Bytyçi, *Ibrahim Rugova: Filozofia politike dhe nacionale*, botim II, Instituti i Studimeve të Europës Juglindore, Tiranë: 2011, f. 78-79.

¹¹ *Po aty*, f. 75.

ndjekur për realizimin e saj, në Europë u përshëndet politika e jodhunës, por nuk u mor parasysh realizimi i objektivit për një Kosovë të pavarur. Projekti evropian ishte thjesht rikthimi i autonomisë së vitit 1974. Në këtë atmosferë, kur konflikti midis shqiptarëve e serbëve thellohej çdo ditë, u mbajt Konferenca e Dayton-it. Mbajtja e kësaj Konference në nëntor 1995 pati si qëllim dhënien fund të konfliktit mbi tre vjeçar në Bosnjë-Hercegovinë. Megjithëse marrëveshja e Dayton-it nuk e zgjidhi përfundimisht konfliktin serbo-kroato-boshnjak, ajo bëri një hap përpara dhe i dha fund konfliktit të armatosur në këtë vend, ku u shkaktuan rreth 200 mijë viktima të pafajshme e të panevojshme.

Por në Kosovë ajo u prit me një zhgënjim e reagim negativ. Zhgënjimi i shqiptarëve ishte i natyrshëm. Ata kishin pritur që të shpërbleheshin për politikën paqësore që zgjodhën në kërkim të lirisë, pavarësisë e demokracisë në këtë vend. Në këto rrethana lindi Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Fuqitë Perendimore, veçmas Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe vendet e tjera të Aleancës së Atlantikut filluan të qëndrojnë akoma më afër problemit të shqiptarëve. Ndonëse Ushtria Çlirimtare e Kosovës u njoftua zyrtarisht në nëntorin e vitit 1997, kur u shfaq publikisht me uniformë, ajo i zhvilloi aksionet e saj edhe më parë. Madje ka të dhëna se lindja e UÇK-së daton diku nga fillimi i viteve 1990, kur edhe qenë hapur kampe të stërvitjes së të rinjve shqiptarë në Labinot të Elbasanit. Por komunikatën e parë UÇK e publikoi në prill 1996.¹²

Me lindjen dhe aksionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës konflikti midis shqiptarëve dhe serbëve u thellua edhe më shumë. Serbia dërgoi në Kosovë repartet e saj speciale si dhe grupe paramilitare e policore të shumta, i armatosi thuajse të gjithë serbët e Kosovës, me qëllim që ata t'i përdorë në aksionin e saj të asgjësimit të shqiptarëve. Në këto kushte UÇK i shpeshtoi aksionet e saj kundër stacioneve policore të Serbisë. Gjatë vitit 1998 lufta dhe konflikti u thelluan më tej. Ndërkohë që njësitë luftarake të UÇK-së bënë aksione të shumta kundër pushtimit serb në Kosovë, njësitë speciale të Ministrisë së Brendshme të Serbisë (Jugosllavisë) u dërguan në zona të ndryshme, sidomos atë të Drenicës dhe bënë masakra të panumërta. Më e madhja masakër ishte ajo e marsit të vitit 1998, në të cilën gjetën vdekjen 56 anëtarë të familjes Jashari në Prekaz. Vrasja e Adem Jasharit në këtë betejë ishte një goditje e rëndë

¹² Revista *Spiegel*, Nr. 41, 7, Oktober 1996, Seite 165.

për lëvizjen çlirimtare të Kosovës. Ai u bë simboli i luftës për liri. Prej kësaj kohe Ushtria Çlirimtare e Kosovës shtoi numrin i luftëtarëve të lirisë dhe tërhoqi vëmendjen e strukturave politike dhe ushtarake të NATO-s si dhe të vendeve demokratike perendimore. Ndërkohë Milosheviçi përfitoi nga momenti dhe mendoi se planin e tij për spastrimin etnik të Kosovës dhe asgjësimin e shqiptarëve mund ta realizonte nën preteksin e "luftës kundër terrorizmit", "fondamentalizmit islamik" ose "separatizmit shqiptar". Ishin këto etiketime që Serbia i kishte përdorur më së shumti gjatë gjithë shekullit të XX dhe me këto artikulime kishte arritur të maskonte aktet e saj terroriste kundër shqiptarëve në Kosovë.¹³ Por bota demokratike dhe Aleanca e Atlantikut i ndoqi me kujdes të gjitha ngjarjet që çuan në thellimin e konfliktit në Kosovë. Në këtë kuptim Perendimi dalloi faktin se Serbia kishte në plan serbizimin e Kosovës, kurse akuzat dhe insinuatat e Beogradit nuk i besoi asnjëherë. Një deklaratë e ish-ndihmës Sekretarit të Shtetit Amerikan, Talbot, sipas të cilit UÇK ishte një organizatë ekstremiste dhe terroriste e bërë në fillimin e pranverës së vitit 1998, duket se u bë që të nxitej Milosheviçi të shtonte aktet e dhunës dhe me këtë të arrihej pajtimi i ndërkombëtarëve për të ndërhyrë ushtarakisht për normalizimin e gjendjes në këtë vend. Fakti që pak muaj më vonë vetë diplomati i shquar Richard Holbrooke shkoi në shtabin e Ushtrisë Çlirimtare dhe u takua në Junik me përfaqësuesit e UÇK-së e dëshmoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për lirinë e shqiptarëve në Kosovë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës u organizua hap pas hapi. Në fillim ajo u zhvillua nën influenca të dukshme ideologjike, gjë që thelloi rivalitetin politik në Kosovë. Lidhja Demokratike e Kosovës nën drejtimin e Presidentit Rugova si dhe qeveria e Bujar Bukoshit stërvitën repartet e tyre luftarake dhe i dërguan ato në Kosovë. Këto njësi luftarake morën emrin FARK (Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës).¹⁴ Gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998 lufta mori përmasa më të mëdha. Në qershor 1998 avionët e NATO-s fluturuan në hapësirën ajrore të Shqipërisë dhe Maqedonisë për të demonstruar gatishmërinë e Aleancës për ndërhyrjen ushtarake për zgjidhjen e konfliktit. Por ndonëse në verën

¹³ Shih për këtë: Erich Rathfelder, *Kosovo - Geschichte eines Konflikts*, Suhrkamp Verlag, Berlin: 2010, Seite 171-172.

¹⁴ Jens Reuter, "Zur Geschichte der UÇK", in: *Der Kosovo-Konflikt, Ursachen, Verlauf, Perspektiven*, Paderbon: 2000, Seite 177.

e atij viti u duk se UÇK kishte avancuar dhe zotëronte rreth 40 përqind të territorit të Kosovës, në vjeshtën e hershme ndodhi e kundërta. Forcat serbe të ushtrisë, policisë dhe të ndërhyrjes së shpejtë ndërmorën një ofensivë të përgjithshme dhe e vunë UÇK-në në një pozitë të vështirë. Pikërisht në kushtet e turrjes së UÇK-së erdhi në ndihmë një ndërhyrje e të dërguarit të posaçëm të Presidentit amerikan, Bill Clinton, Richard Holbrooke. Në tetor 1998 Holbrooke e detyroi Milosheviçin të nënshkruante një marrëveshje armëpushimi, të cilin do ta kontrollonte një grup vëzhguesisht i OSBE-së i përbërë prej 2000 vetash. Kjo marrëveshje u dha kohë të dy palëve që të përgatiteshin për të rifilluar luftën midis tyre.¹⁵

Aktivizimi i diplomacisë ndërkombëtare

Aktivizimi i diplomacisë ndërkombëtare për evitimin e një konflikti të gjerë përfshiu të gjitha organizmat dhe strukturat europiane e më gjerë, deri te Këshilli i Sigurimit të OKB-së. Në tetor 1998 Këshilli i NATO-s rekomandoi hartimin e planeve për ndërhyrjen ushtarake në Kosovë dhe zgjidhjen me dhunë të konfliktit shqiptaro-serb. Në maj të atij viti Këshilli i Sigurimit miratoi një rezolutë, si dhe një tjetër në fund të shtatorit. Ndërsa në rezolutën e tetorit ai miratoi misionin vëzhgues të OSBE-së bazuar në marrëveshjen Milosheviç-Holbrooke. Në të gjitha rezolutat e Këshillit të Sigurimit të dy palëve iu bë thirrje që të përmbaheshin nga aktet e dhunës, por njëkohësisht Beogradit iu kërkua me insistim të ofrojë një zgjidhje paqësore përmes dialogut sa i përket statusit të Kosovës. Ndërkaq në rezolutën e muajit shtator situata në Kosovë u konsiderua si eksplozive dhe me rrezik për stabilitetin rajonal e më gjerë. Por Milosheviçi nuk pranoi në asnjë rast të gjente një zgjidhje të mundëshme paqësore dhe të bisedonte me shqiptarët.¹⁶

Për këto arsye janari i vitit 1999 shënoi rifillimin e luftës madje me mjete dhe forma ende më radikale. Ushtria dhe policia e Serbisë bëri më 15 janar 1999 masakrën e radhës në fshatin Reçak, afër qytetit të Shtimjes, në jug të Prishtinës. Kreu i misionit të OSBE-së, ambasadori amerikan, William Walker, shkoi në vendngjarje dhe i provoi botës se aty

¹⁵ Auszüge in deutscher Sprache in den "Hintergrundinformationen zum Einsatz der internationalen Staatengemeinschaft in Kosovo und zur Beteiligung der Bundeswehr: Stichworte für die Öffentlichkeitsarbeit und Truppeninformation. Hg. Bundesministerium der Verteidigung, Bonn: 1999.

¹⁶ Agjensia gjermane e lajmeve DPA, 19.10.1998.

ishin vrarë me plumba dhe nga afër 45 shqiptarë të paarmatosur, midis të cilëve fëmijë dhe gra. Një ngjarje si kjo e sensibilizoi opinionin botëror, ndërkohë që ShBA-të ndërmorën aksionin diplomatik për të përgatitur një konferencë të posaçme për Kosovën. Në këto rrethana u përgatit dhe u mbajt Konferenca e Rambujesë. Ajo i filloi punimet e saj më 6 shkurt 1999 në Kështjellën e Rambujesë në Francë dhe vazhdoi deri më 23 shkurt të atij viti. Në të morën pjesë të gjashtë ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit, SHBA-ve, Ruisë, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Francës dhe Italisë si dhe anëtarët e dy delegacioneve, atij të Serbisë dhe të shqiptarëve të Kosovës. Qëllimi i Konferencës ishte evitimi i një konflikti tjetër të përmasave të Bosnjës.¹⁷

Në Konferencë u paraqit një projekt politik, si dhe projekti ushtarak për zgjidhjen e krizës. Sipas projektit politik Serbia ruante sovranitetin e saj në Kosovë. Ajo do të kontrollonte politikat e mbrojtjes së kufijve dhe të jashtme dhe në vend do të kishte së paku 2000 policë dhe po kaq forca ushtarake. Ndërkaq Kosova do të vetëqeverisej, duke zhvilluar zgjedhjet demokratike. Ajo do të kishte parlamentin, presidentin, qeverinë, gjykatën kushtetuese dhe gjykatën e lartë. Ky status u përcaktua për një periudhë kalimtare, sepse me insistimin e delegacionit të Kosovës u parashikua që pas tri vitesh të bëhej një referendum për statusin e ardhshëm të saj. Ndërsa projekti ushtarak parashikonte që siguria, qetësia dhe stabiliteti i Kosovës të implementohej nga NATO. Aleanca e Atlantikut dhe prezenca e saj në Kosovë i jepte garancitë e nevojshme zhvillimeve politike për stabilitet dhe paqe në të gjithë rajonin.

Por delegacioni i Serbisë e hodhi poshtë marrëveshjen, sidomos pjesën ushtarake të saj, ndërkohë që në terren Serbia grumbulloi mbi 40 mijë forca ushtarake, të gatshme për të ndërmarrë akte dhune e të terrori kundër shqiptarëve në Kosovë.¹⁸

¹⁷ Konrad Clewing, Oliver Jens Schmitt, "Alamiert von den Berichten über neue serbische Gräueltaten im Januar 1999 und fest entschlossen, eine Eskalation wie im Falls Bosniens zu verhindern, führten die Vereinigten Staaten und die führende europäischen Mächte ab Februar 1999 im französischen Rambouillet mit der serbischen Regierung und den Vertretern der Kosovaren Verhandlungen über den Status von Kosovo". Geschichte Südosteuropas - Vom frühen Mittelalter bis zur Gegenwart, Verlag Friedrich Pustet, Regensburg, 2011, Seite 747.

¹⁸ Stefan Troebst, *Die Konfliktenentwicklung auf dem südlichen Balkan I*. Information für Sicherheitspolitik nr 17, Juni 1999.

Delegacioni i shqiptarëve u kryesua nga shefi politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi. Ky delegacion kërkoj dy garanci, prezencën e NATO-s në Kosovë si dhe referendumin për të përcaktuar pas tri vitesh të ardhmen e saj. Megjithëse të dy kërkesat u premtuan nga ana e organizatorëve të Konferencës, me këmbnguljen e Thaçit, u desh që marrëveshja të nënshkruhej pas tri javësh, përkatësisht më 15 mars 1999, nga ana e delegacionit shqiptar. Nënshkrimi i saj prej palës shqiptare dhe refuzimi i serbëve motivuan që Aleanca e Atlantikut të mandatohej për të ndërhyrë me forcë për vendosjen e paqes e të stabilitetit në vend.

Sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë (Serbisë) filluan natën e 24 marsit 1999, pasi që presidenti amerikan, Bill Clinton, aktivizoi urdhërin e tij për të vënë në lëvizje ushtrinë amerikane e atë të Aleancës. Sulmet ajrore morën miratimin e të gjitha vendeve anëtare të NATO-s. Gjermania për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore aktivizoi ushtrinë e saj në një sulm kundër një vendi tjetër, Jugosllavisë (Serbisë). Ndërsa Britania e Madhe dhe kryeministri i saj, Tony Blair, vunë në lëvizje të gjitha mekanizmat politike dhe diplomatike për të aktivizuar forcat tokësore të NATO-s, nëse sulmet ajrore nuk do ta arrinin objektivin për të mposhtur makinerinë ushtarake të Serbisë. Qëllimi i luftës ishte të dobësonte dhe shkatërronte arsenalin ushtarak serb si dhe të paralizonte forcën e ushtrisë së Serbisë për ta bërë atë të paaftë të vepronte në Kosovë për spastrimin etnik të saj.¹⁹

Sulmet e NATO-s

Ndërhyrja u motivua me dy argumente të rëndësishme, përkatësisht parandalimin e një katastrofë humanitare të pashembullt pas Luftës së Dytë Botërore, si dhe parandalimin e zgjerimit të konfliktit në rajon e më gjerë. Makineria ushtarake dhe policore e Serbisë dëboi në pak muaj rreth një milion shqiptarë dhe asgjësoi, masakroi dhe zhduku pa lënë gjurmë rreth 15 mijë të tjerë. Nëse NATO dhe komuniteti ndërkombëtar nuk do të ndërhynte, atëherë Kosova do të spastrohej plotësisht etnikisht dhe të vrarët në popullsinë shqiptare do t'i kalonin viktimat e Bosnjës. Për planin e asgjësimit të shqiptarëve dhe serbizimin e Kosovës NATO kishte në dorë gjithashtu një dokument të hartuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Jugosllave (serbe), të cilin ia kishte dorëzuar qeveria e

¹⁹ <http://www.glasnost.de/kosovo/990324clinton.html>

Bullgarisë.²⁰ NATO i filloi sulmet ajrore të saj pa patur një mandat të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Rusia, si kujdestare e përhershme e Serbisë, mori në mbrojtje regjimin e egër dhe terrorist të Milosheviçit dhe i dha atij garanci se nuk do të pranonte një ndërhyrje ushtarake nga jashtë kundër Serbisë. Për këtë arsye Rusia paralajmëroi veton e saj kundër sulmeve ajrore, ndërkohë që vendet e tjera anëtare të këtij këshilli nuk e çuan një projekt rezolutë në këtë këshill. Sipas SHBA-ve, Britanisë së Madhe dhe Francës, tri nga pesë anëtarët e Përhershme të KS, rezoluta e shtatorit 1998 ishte e mjaftueshme për autorizimin e ndërhyrjes ushtarake në Kosovë, sepse në atë rezolutë thuhej se në këtë vend kishte një katastrofë humanitare dhe përmendej fakti se konflikti në Kosovë kërcënon paqen dhe stabilitetin europian. Ishin të mjaftueshme këto konstatime, për të cilat kishte votuar Rusia, që në përmbajtje ndërhyrja ushtarake e NATO-s të ishte e justifikuar dhe e mbështetur në Kartën e OKB-së, në të cilën parashihet se ndërhyrja e armatosur mund të motivohet vetëm në rastet kur shkaktohen katastrofa humanitare ose në rastet kur konfliktet mund të zgjerohen dhe ato kërcënojnë stabilitetin dhe paqen botërore.

Megjithatë u vunë në antitezë dy qëndrime të kundërta dhe dy koncepte të ndryshme. Nga njëra anë qëndrimi i Rusisë i bazuar në interesat e ngushta të saj për shtrirjen e sundimit dhe ekspansionit në Ballkan. Për pasojë ajo mori në mbrojtje një regjim të dhunshëm që kishte ndërmarrë fushatën e spastrimit etnik e të asgjësimit të shqiptarëve. Madje presidenti rus, Boris Jelcin paralajmëronte Fuqitë Perendimore se "Nëse ju kërcënoni me një aksion ushtarak, atëherë Europa e ndoshta bota do të ketë një luftë të tretë".²¹ Në anën tjetër ishin fuqitë perendimore me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat kërkuan ndalimin e dhunës, parandalimin e katastrofës humanitare të refugjatëve shqiptarë, parandalimin e shkatërrimit të pronave të tyre, si dhe ruajtjen e stabilitetit e të paqes në Europë. Ndërsa për Rusinë paqja e stabiliteti europian ose jetët njerëzore nuk kishin asnjë rëndësi, për Europën dhe Shtetet e Bashkuara të dy këta elementë kishin vlera morale dhe politike

²⁰ Shih gjithashtu:

<http://www.top-channel.tv/artikull.php?i=226536&ref=fp>.

Njoftimi për ekzistencën e këtij plani është pasqyruar në janar 2012 në faqen e internetit të lajmeve të TV Top Channel. Ndërkohë që është dhënë edhe nga media të tjera.

²¹ *The Moscow Times*, 13.4.1999.

të pakontestueshme. Interesi euro-amerikan ishte dhe mbetet stabiliteti dhe paqja, integrimi dhe harmonia kontinentale dhe ndërkontinentale, si kusht i domozdoshëm për paqen dhe stabilitetin në botë. Interesi rus ishte dhe mbetet edhe në ditët e sotme destabiliteti dhe mbështetja e dhunës me qëllim realizimin e politikave pansllaviste në Ballkan.

Por mungesa e mandatit të Këshillit të Sigurimit për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë shkaktoi një debat të madh pro dhe kundër këtyre aksioneve. Thelbi i diskutimeve dhe qëndrimeve ka të bëjë me legjitimitetin ose jolegjitimitetin e sulmeve ajrore të Aleancës së Atlantikut kundër Jugosllavisë (Serbisë). Parë nga ana formale, duket sikur NATO në aksionin e saj në Kosovë veprroi në mënyrë arbitrarë dhe mori rolin dhe kompetencat e Këshillit të Sigurimit. Mungesa e një mandati të Këshillit të Sigurimit formalisht e dukej se e delegjitimoi ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë. Por politikisht dhe moralisht kjo ndërhyrje ishte e legjitimuar. Në përmbajtje ky legjitimitet vinte nga konstatimi i shtatorit 1999 i Këshillit të Sigurimit se konflikti në Kosovë përbente një rrezik për paqen e stabilitetin në Europë. Po ashtu për shkak se thuajse në të gjitha rezolutat e KS përmendej dhe konstatohej fakti që situata në Kosovë përbën një shqetësim ndërkombëtar humanitar. Konsensusi i të gjitha vendeve të NATO-s shihet si argument pro sulmeve ajrore. Ndërkaq legjitimiteti i këtij aksioni ushtarak arsyetohet edhe nga disa faktorë të tjerë.

Thelbi i konfliktit shqiptaro-serb qëndron në mitizimin e historisë së Serbisë. Shkak i konfliktit ishte nacionalist serb i viktimizimit të Serbisë, cili prodhoi deduksionin se “Serbët fitojnë në luftë dhe humbasin në paqe”.²² Fatkeqësisht është zor të gjendet ndonjë shembull i homogjenizimit kaq të madh të ndonjë kombi tjetër evropian në fikcionin se “ata janë popull superior” dhe për këtë shkak “kanë të gjitha të drejtat legjitime për ushtrimin e dhunës e të terrorit mbi popujt e tjerë”. Dehumanizimi serb i skajshëm në kohën e një bote të humanizuar ishte gjithashtu shkak i terrorit serb kundër shqiptarëve e për rrjedhojë i përdorimit të forcës ushtarake NATO-s për zgjidhjen e konfliktit shqiptaro-serb.

Gjatë konfliktit prej më shumë se njëshekullor midis shqiptarëve dhe serbëve, shqiptarët nuk patën asnjë mundësi reale për të sensibilizuar

²² Shih për këtë: Enver Bytyçi, *Shqiptarët, serbët dhe grekët*, Tiranë: “Koha”, 2005, f. 23.

botën në përkrahje të tyre. Kjo për arsye të raporteve ndërkombëtare, të ekuilibrave të Fuqive të Mëdha, por edhe për shkak të organizimit të dobët, vonesës së shtetformimit e praktikave individualiste në luftërat për liri. Periudha e dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit XX është periudha e veprimit për çlirim kombëtar bazuar në një filozofi të re politike e nacionale, e cila merrte parasysh katër elementë të rëndësishëm të kulturës: *Së pari*, shqiptarët mundën të përhapnin të vërtetën se ata i përkasin botës së civilizuar me veçori dalluese në gjuhë, në zakone, në tradita, në mentalitet dhe në simbolet e jetesës. *Së dyti*, shqiptarët në Kosovë kuptuan më shpejt sesa serbët trendin e zhvillimit të botës së sotme moderne dhe prirjen drejt një bote humane. Nocionin, vetëdijën dhe veprimin civilizues ata e përvetësuan në një kohë rekord krahasuar me kombet e tjera, kjo edhe për shkak të nevojës për ta përdorur atë si armë mbrojtëse përballë politikave të dhunës e të terrorit serb në Kosovë. *Së treti*, nisur nga nevoja për suksesin e luftës për liri, shqiptarët mundën dhe ia arritën që për herë të parë në histori të përcaktonin normat akomoduese të sjelljes së tyre në kushtet e pushtimit e të sundimit të Serbisë, mbështetur në teorinë dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke u shndërruar shkallë-shkallë në një subjekt ndërkombëtar i njohur si palë në një konflikt real e të rrezikshëm. *Së katërti*, shqiptarët arritën që për herë të parë të formonin një kompaktësim real dhe të pashembullt në përpjekjet e tyre për liri dhe çlirim nacional, aq sa regjimi i Beogradit nuk mundi të gjente qoftë dhe një grusht prej tyre për t'i joshur si bashkëpunëtorë kundër lirisë dhe pavarësisë së vendit.

Prandaj diplomacia ndërkombëtare veprroi me forcë të pazakontë për t'i dhënë zgjidhje konfliktit. Por ajo nuk pati sukses. Për pasojë u bë i domozdoshëm përdorimi i forcës. Pa përdorimin e forcës nuk mund të evitohet një katastrofë e pashmangshme humanitare në Kosovë, si dhe nuk mund të arrihet paqja dhe stabiliteti në rajon. Pa ndërhyrjen ushtarake të Aleancës konflikti do të shtrihej më gjerë dhe do të përhapej përtej rajonit, në kontinentin europian. Një analizë e ftohtë e konfliktit shqiptaro-serb, e ekzaminuar në rrjedhat historike dhe aktuale, çonte në logjikën e zgjerimit të vatrës së krizës. Aleanca Atlantike nuk mund të lejonte që kjo të ndodhte. Ajo nuk mund të vinte në pikëpyetje ekzistencën e saj. Përfundimisht NATO, me sulmet e saj kundër Jugosllavisë (Serbisë) i dha fund burimit të një konflikti që rrezikonte paqen e stabilitetin e Europës Juglindore si dhe të vetë Aleancës e të

Bashkimit Europian. Në këtë kuptim, sukcesi i luftës në Kosovë dhe fitorja e NATO-s u bënë faktorë të stabilitetit. Nuk dolën parashikimet e skeptikëve, kritikëve dhe kundërshtarëve të luftës e të NATO-s, sipas të cilëve sulmet ajrore kundër Jugosllavisë (Serbisë) do të bëhen shkak i një tragjedie rajonale, kontinentale e më gjerë. Pas luftës dhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës rajoni, Kosova dhe vetë Serbia janë më stabile dhe më afër Bashkimit Europian. Vendet e Europës Juglindore kanë intensifikuar bashkëpunimin dhe integrimin e ndërsjelltë. Shumica e qytetarëve të këtyre vendeve lëvizin të lirë në vendet e Bashkimit Europian. Disa vende si Shqipëria dhe Kroacia u bënë anëtare të Aleancës së Atlantikut. Dhe bashkëpunimi ekonomik, lëvizja e lirë e mallrave, janë realitete të reja.

Uniteti i vendeve anëtare të NATO-s ishte faktori vendimtar i suksesit të saj. Milosheviçi kishte shpresuar shumë në përçarjen e Aleancës. Por kjo nuk ndodhi kryesisht për shkak të diplomacisë së shkathët të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe sekretares së Shtetit, Allbright.²³ Nuk kishte ndodhur gjithashtu për faktin se SHBA-të udhëhoqën një proces diplomatik e politik për zgjidhjen e krizës, me të cilin nuk mund të justifikoheshin asnjë vend për veton e tij kundër sulmeve ushtarake. U miratuan 4 rezoluta në Këshillin e Sigurimit, të cilat në vijimësi e gjithnjë më me ashpërsi kritikuan dhe e vunë Beogradin para përgjegjësisë si shkaktar të konfliktit. U rekomanduan zgjidhje të shumta, të cilat u refuzuan me kokëfortësi nga regjimi i Milosheviçit. U zhvilluan demarrshe politike e diplomatike shumëpalëshe dhe dypalëshe si asnjëherë tjetër, për t'i dhënë fund dhunës dhe për të gjetur një zgjidhje të pranueshme përmes dialogut, ndërkohë që të gjitha iniciativat e tilla u refuzuan nga Milosheviçi. U organizua një konferencë ndërkombëtare, ajo e Rambujesë, projekti i së cilës përsëri u refuzua kategorikisht nga qeveria e Serbisë, ndërkohë që u pranua nga pala shqiptare. Para këtyre fakteve nuk pati asnjë mundësi që të reagoje negativisht ndonjë vend anëtar i NATO-s. Megjithatë inskenimet në prapaskenë nuk i munguan as këtij procesi, por ato dështuan përballë argumentit të domozdoshmërisë së zgjidhjes së konfliktit vetëm përmes sulmeve ajrore dhe ndërhyrjes

²³ Shih për këtë: James Rubin, *Një luftë shumë personale*, Tiranë: "Klan", 2000; Sabrina P. Ramet, "Die politische Strategie der Vereinigten Staaten in der Kosovo-Krise: Parteipolitik und nationales Interesse", in *Der Kosovo-Konflikt, Ursachen, Verlauf, Perspektiven*, Wieser Verlag, München: 2000, Seite 369-370.

ushtarake.²⁴ Duke patur parasysh faktin se Grupi i Kontaktit luajti një rol të rëndësishëm në ndjekjen e situatave të konfliktit si dhe zbutjen e tij, konstatohet nga ana tjetër se vendet anëtare të këtij Grupi nuk qenë të një mendjeje për përdorimin e forcës. Aktorët e grupit ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vendet kryesore të Bashkimit European si dhe Rusia. Eksperienca e punës së tij dëshmoi se suksesi i operacioneve ushtarake në Kosovë si dhe diplomacisë preventive para këtyre aksioneve nuk qëndronte thjesht në instrumentet e vendimmarrjes, por në unitetin e aktorëve në vendimmarrje.

Faktori i brendshëm në Kosovë, Lëvizja Paqësore e Shqiptarëve, e udhëhequr nga lideri Ibrahim Rugova, si dhe Lëvizja Çlirimtare e Kosovës e përfaqësuar politikisht nga Hashim Thaçi, patën ndikime të pazvendësueshme për iniciativën e NATO-s për ndërhyrje me anën e forcës ushtarake. Disiplina politike e shqiptarëve në Kosovë dhe përkushtimi i tyre për të respektuar autoritetin ndërkombëtar, përkatësisht autoritetin e NATO-s, ishte një faktor shumë i rëndësishëm që favorizoi angazhimin e botës demokratike në zgjidhjen e konfliktit në Kosovë.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës u bë partnere e komunitetit ndërkombëtar dhe e Aleancës së Atlantikut, duke marrë statusin e një subjekti. Megjithë konfliktet e brendshme politike të faktorit shqiptar në Kosovë, meritë e madhe e tij ishte përcaktimi i qartë dhe i drejtë në krah të aleancës së Perendimit.

Sulmet ajrore të NATO-s në Kosovë u paraprinë nga një veprimtari intensive e komunitetit ndërkombëtar për prevenimin e konfliktit. Përgjegjësinë kryesore për këtë duhej ta kishin shtetet anëtare të Bashkimit European, por në të vërtetë rolin kryesor e luajtën Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndonëse europeanët kuptuan se kishin përgjegjësinë kryesore për evitimin e konfliktit, ato nuk u vetëdijësuan se në rast të dështimit do të duhej të mbartnin edhe përgjegjësinë kryesore të reagimit.²⁵ Ndërkaq ato, për të mënjeluar justifikimet europiane, tërhoqën Rusinë në vendimmarrjen e Perendimit. Ftesa e Perendimit për bashkëpunimin e Rusisë u dëshmuua në disa raste si një hap i drejtë diplomatik dhe politik. Por qëndrimi rus i kohës së bombardimeve ishte tejet i ashpër. Kosova shërbeu për Moskën si një rast ideal dhe si alibi për të ndërtuar një politikë agresive kundër demokracive perendimore.

²⁴ J. Rubin, *Një luftë shumë personale...*, f. 26.

²⁵ *Po aty*, f. 9.

Sulmet e NATO-s në Kosovë shënuan fundin e një kohe dhe fillimin e një epoke të re. Prej qershorit 1999 bota mori mesazhin se nuk ka dhe nuk do të ketë më thjesht “konflikte të brendëshme”, por do të kishte konflikte me ndikim rajonal e global. Për pasojë ato do të duheshin zgjidhur me dialog dhe kompromis, në të kundërt do të duhej angazhimi i një forcë globale. NATO-ja dëshmoi se ishte e aftë ta merrte këtë rol të rëndësishëm, jo në funksion të një xhandari ndërkombëtar, por në funksion të zhvillimit të politikave globaliste. Edhe nëse Këshilli i Sigurimit do të vendoste për ndërhyrjen me forcë në Kosovë, ai nuk kishte asnjë autoritet e instrument t’i imponohej NATO-s për këtë. Në këtë rast Këshilli i Sigurimit do të dëshmonte paaftësinë e tij për zgjidhjen e krizës. Në këtë kuptim NATO mbetet instrumenti i vetëm për zgjidhjen e konflikteve. Dhe nëse e pranojmë këtë realitet, atëherë do të duhet të veçojmë faktin se Këshilli i Sigurimit, sa kohë që nuk ka forcën ushtarake për ta përdorur në vatrat e krizave, ai nuk mund të realizojë vendimet e veta.

Në këto kushte bota e civilizuar e vlerave amerikane dhe europiane kishte përpara vetëm dy alternativa: Ose të ndërhynte ushtarakisht dhe t’i jepte fund konfliktit në Kosovë, ose të bënte sehirxhiun dhe të pranonte si model të rregullit të ri botëror veprimet antinjerëzore të shtetit të Serbisë, i cili mobilizoi të gjitha potencialet e tij për të asgjësuar gati dy milionë shqiptarë, banorë të Kosovës. Kritikët e sulmeve ushtarake të NATO-s, ndonëse nuk e pohojnë faktin se ishin për asgjësimin e shqiptarëve, në të vërtetë i kontribuan alternativës së dehumanizimit të botës, duke mbetur idhtarë të ruajtjes së statuskuosë.

Ndëkaq përkrahësit e sulmeve ajrore vunë re me shqetësim se mosreagimi para një katastrofe të tillë humanitare dhe zhdukjes së kombeve me dhunë për interesa nacionaliste e shoviniste do t’i jepte botës një dimension jo njerëzor. Ndërhyrja ushtarake e Aleancës së Atlantikut nën komandën e SHBA-ve ishte produkt i nevojës për ndërtimin e një bote më të mirë, më të civilizuar dhe më të paqte. Në këtë kuptim mund të dalim në përfundimin se vetoja ruse në Këshillin e Sigurimit kishte ekuivalencën e dëmtimit të interesave humanizuese të botës perspektivës së popujve për të prosperuar në paqe, stabilitet, harmoni dhe integritet të ndërsjelltë.

Ndaj u nxit nisma për reformimin thelbësor të të drejtës ndërkombëtare si dhe të instrumenteve të saj, duke filluar prej Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Sigurimit. Iniciativa e Butros Butros Ghalit në

këtë drejtim ishte produkt i përvojës së konfliktit në Kosovë. Por propozimet e Komisionit përkatës për reformimin e OKB-së dhe të Këshillit të Sigurimit kanë mbetur ende në letër. Edhe në këtë rast pengon e drejta e vetos, të cilën e ushtrojnë pesë shtetet anëtare të Përhershme të Këshillit të Sigurimit. Ndoshta është me interes që krahas reformës për të drejtat dhe detyrimet e Këshillit të Sigurimit dhe anëtarëve të tij të përhershëm ose të përkohshëm, të rishihet dhe riformulohet vetë Karta e OKB-së, me qëllim që të përfshihet në të më mirë e drejta e kombeve dhe detyrimi i shteteve për zgjidhjen e konflikteve përmes dialogut. Krijimi i një ekuilibri midis të drejtës së shteteve dhe të drejtës së kombeve, të njerëzve, të pakicave nacionale ose fetare duket si imperativ i kohës. Konflikti i Kosovës ishte dhe mbetet një përvojë e pasur për këtë.

Ndërhyrja së NATO-s për t'i dhënë fund konfliktit në Kosovë ishte kusht i domozdoshëm për realizimin e politikës së sigurisë në Europë. Pa zgjidhjen e këtij konflikti nuk mund të kishte një Europë të Bashkuar. Nëse shqiptarët dhe serbët do të lireshin në mëshirën e fatit, atëherë konflikti midis të dy popujve do të vazhdonte me dekada. Por Europa nuk mund të priste aq gjatë një zgjidhje të pranueshme të këtij konflikti, përveçse Milosheviçi me genocidin e tij në zemër të Europës po krijonte një precedent të rrezikshëm për fatin e kontinentit. Prandaj kohezioni i veprimeve ushtarake të NATO-s ishte gjithashtu kohezioni i së ardhmes së Bashkimit European.

Leksioni kryesor i ndërhyrjes ushtarake të NATO-s ka të bëjë me shkurtimin e kohës së lëvizshme si dhe të kohës së hezitimit për t'u shkuar në ndihmë popujve, kombeve, grupeve etnike e fetare në kohën e duhur, kur ato rrezikojnë ekzistencën e tyre për shkak të dhunës që vinte nga jashtë ose brenda territorit të shtetit ku ata jetojnë. Ndërhyrja në Kosovë de facto u mbështet në artikullin 1, paragrafi 2 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, sipas të cilit Këshilli i Sigurimit të OKB-së kishte të drejtën të autorizonte përdorimin e forcës në konfliktet, të cilat rrezikonin paqen dhe stabilitetin global. Analizat, ekspertizat, faktet, argumentet provojnë pa kurrëfarë mëdyshje se konflikti në Kosovë dhe spastrimi etnik serb kundër shqiptarëve do të çonte në përfshirjen në luftë të disa vendeve të Europës Juglindore e për pasojë rrezikimin e paqes e të stabilitetit global. Por në bazë të artikullit 51 të Kartës së Kombeve të Bashkuara autorizimin për një ndërhyrje ushtarake në një konflikt të caktuar duhet ta jepë Këshilli i Sigurimit. Mungesa e një autorizimi të

tillë në rastin e Kosovës është interpretuar si shkelje e së drejtës ndërkombëtare, duke i dhënë më shumë rëndësi formës sesa përmbajtjes.

Një ndër tiparet e rëndësishme të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë ishte fakti që për herë të parë morën përparësi të drejtat njërezore, komunitare, qytetare dhe kombëtare të një populli, në raport me sovranitetin e një shteti, i cili ushtroi dhunë e terror mbi qytetarët e një kombësie të ndryshme nga popullsia shumicë. Përparësia e vetëvendosjes kapërceu domozdoshmërinë e respektimit të sovranitetit të Serbisë në Kosovë, pasi që Beogradi veproi sipas një plani për asgjësimin fizik të shqiptarëve, të cilin qeveria e bullgare e dorëzoi te autoritet e NATO-s dhe te ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Joschka Fischer, shërbeu si dokument i mjaftueshëm për të provuar se Milosheviçi po vepronte me metoda mizore kundër shqiptarëve.²⁶

Nga pikëpamja morale NATO veproi në ndihmë të viktimave. Ndihma dhe mbështetja kryesore e saj shkoi në dobi të shqiptarëve viktimë e krimeve mizore të aparatit të dhunës serbe. Në këtë kuptim ndërhyrja ushtarake e NATO-s në Kosovë si dhe angazhimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe vendeve të BE-së janë të justifikuara si vepër e vlerave morale në ndihmë të viktimave të dhunës e terrorit shtetëror serb. Për të parandaluar akte të tilla kundër njerëzimit vepruan shumë prej organizatave prestigjioze me karakter ndërnacional, midis të cilave Këshilli i Europës dhe OSBE-ja. Se ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ka karakter moral të fuqishëm, këtë e dëshmon fakti se trupat e saj kanë ardhur në pakësim të vazhdueshëm, në përputhje me situatën e stabilitetit e të sigurisë në vend. Ndërkaq duhet theksuar fakti se KFOR-i u prit në Kosovë me entuziazëm nga shumica dërmuese e popullsisë, çka dëshmon për vlerat morale të ndërhyrjes së saj. Një luftë e pamoralshme nuk mund të gjejë përkrahje të tillë nga ana e popullsisë vendase. NATO dhe trupa e saj në Kosovë, KFOR-i, dëshmuar se janë aty për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, të cilat rrezikohen nga ndërhyrjet e Beogradit në këtë vend. Periudha që prej vitit 1999 është provë e faktit se NATO dhe KFOR-i janë ende të domozdoshëm në Kosovë, për shkak të inervenimit të vazhdueshëm të Serbisë dhe Rusisë për destabilizimin e saj. Diversioni

²⁶ Shih gjithashtu:

<http://www.top-channel.tv/artikull.php?i=226536&ref=fp>.

Ky lajm është marrë në portalin e lajmeve të Top Channel në janar 2012 dhe nuk është përgënjeshtuar nga asnjë prej aktorëve të përmendur.

serb në veri të Kosovës dëshmon për atë sesa e rrezikshme do të ishte mosndërhyrja e NATO-s në Kosovë..

Për të pasur një ide të qartë për legjitimitetin ose jo të sulmeve të Aleancës së Atlantikut kundër Jugosllavisë (Serbisë) është e domosdoshme të sqarohet nocioni, nëse këto sulme ishin të drejta ose jo.²⁷ NATO gjatë aksionit të saj ushtarak nuk pretendoi të pushtonte asnjë pjesë të territorit të Jugosllavisë (Serbisë). Ajo kishte si qëllim thjesht imponimin e paqes e të stabilitetit dhe dobësimin e fuqisë ushtarake të Serbisë. Ato nuk u bënë si projekt i një lufte pushtuese. Ndërsa nga pikëpamja e së drejtës juridike ndërkombëtare prania e NATO-s në Kosovë është e rregulluar përmes Rezolutës 1244, me të cilën legjitimohet ndërhyrja në Kosovë.

Ekspertët e kanë klasifikuar ndërhyrjen e Aleancës në Kosovë si një luftë të drejtë nga pikëpamja morale dhe politike. Dhe derisa sulmet kundër Jugosllavisë (Serbisë) u klasifikuan si aksion i legjitimuar në pikëpamje të politikës dhe moralit, atëherë nuk mund të anashkalohet fakti se lufta në Kosovë ishte një luftë e drejtë, e motivuar nga shkaqe madhore dhe nga domosdoshmëria e parandalimit të një katastrofe humanitare si dhe nga nevoja për ruajtjen e stabilitetit e të paqes në rajon.²⁸ Nisur nga të gjitha këto arsytetime del se NATO nuk ishte agresore kundër Serbisë dhe popullsisë së saj, por ajo e përdori forcën e saj për të shkatërruar potencialin ushtarak të një vendi agresor e luftënxitës, me qëllim krijimin e kushteve për paqe e stabilitet në Kosovë, në Serbi e në rajonin e Europës Juglindore. Gjatë aksioneve ushtarake personalitetet kryesore të shteteve anëtare të NATO-s vunë disa herë në dukje se aksioni ushtarak nuk drejtohet kundër popullit serb.²⁹

Statusi i Kosovës u vendos më 17 shkurt të vitit 2008 me shpalljen e pavarësisë së saj. Ndërkaq më 22 korrik të vitit 2010 Gjykata Ndërkombëtare e Hagës shpalli vendimin e legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës. Në vendimin në fjalë thuhej se shpallja e pavarësisë së Kosovës është realizuar në bazë të të drejtës ndërkombëtare si dhe në pajtim me Rezolutën 1244 të OKB-së, me të cilën Kosova u vu nën administrim ndërkombëtar. Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë

²⁷ Stefan Gruber, *Die Lehre vom gerechten Krieg - Eine Einführung am Beispiel der NATO-Intervention im Kosovo*, Tecktum Verlag, Margurg: 2008, Seite 15.

²⁸ Gazeta *Die Zeit*, 12 Mai 1999.

²⁹ Senator Richard Lugar në një konferencë shtypi në galerinë e Radios së Senatit (2:2:1999), Federal News service, auf Lexis-Nexis Congressional Universe.

habiti jo vetëm ankimesit e Beogradit, përkatësisht qeverinë e Serbisë, e cila u ankua, duke kërkuar verifikimin ligjor në bazë të së drejtës ndërkombëtare të legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës ose jo. GjND në Hagë surprizoi vetë Prishtinën, sepse shumë prej shqiptarëve ishin skeptikë për pozitivitetin e vendimit të saj. Në fakt Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë i dha përgjigje pozitive jo vetëm legjitimitetit të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Ajo me këtë vendim legjitimoi de facto ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në Kosovë.³⁰

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s e 24 marsit 1999 kundër forcave ushtarake dhe policore të Serbisë si dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës janë rezultat logjik i të njëjtit proces. Aksioni ushtarak i NATO-s përcaktoi gjithashtu të ardhmen e Kosovës, e ardhme e parashikuar në rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të 10 qershorit 1999. Rezoluta në fjalë e çoi Kosovën nën administrim ndërkombëtar. Serbia nuk do të kishte më të drejtën legjitime për qeverisjen e Kosovës, as për të patur prezencën e saj me trupa ushtarake e policore. Përgjegjëse për administrimin e Kosovës, sipas rezolutës, ishin OKB, OSBE dhe NATO. Ndërkaq vendimi i GjND-së në Hagë i 22 korrikut 2010 legjitimoi gjithashtu shpalljen e pavarësisë së Kosovës si akt në pajtim edhe me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Nëse i shqyrtojmë të gjitha proceset në ndërvarësi e në lidhje logjike midis tyre, atëherë do të vlerësonim se rezolutat e vitit 1998-1999 të Këshillit të Sigurimit për Kosovën, marrëveshja e Rambujesë e shkurtmarsit 1999 e panënshkruar nga pala serbe, rezoluta 1244 e 10 qershorit 1999 për implementimin e protektoratit ushtarak e civil të Kosovës nën patronazhin e OKB-së nga pikëpamja e administrimit dhe të NATO-s nga pikëpamja e sigurisë, kanë shërbyer si elementë të rëndësishëm në vendimmarrjen e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë për njohjen e legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës si dhe të integritetit të saj. Ky është njëkohësisht akt i legjitimitetit të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s kundër Jugosllavisë dhe i jep fund spekulimeve për jolegjitimitetin e të gjithë procesit të zhvillimeve në Kosovës.

Bombardimet e NATO-s kundër Jugosllavisë (Serbisë) dëshmuan dhe një realitet tjetër. Pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës konflikti në Kosovë nuk do të zgjidhej dhe Europa do të përjetonte një krizë të thellë identiteti, besimi dhe integriteti. Europa, e cila nguroi për të ndërhyrë në

³⁰ *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, 23.10.2010.

Bosnjë, ende nuk ishte e gatshme të përballonte e vetme zgjidhjen e një konflikti të përmasave të tilla. Ishin amerikanët ata që udhëhoqën betejën diplomatike e të luftës në Kosovë dhe e fituan atë. Ky fakt historik i patjetërsueshëm rriti autoritetin dhe prestigjin e SHBA-ve. Fakt është se ndërhyrja e NATO-s dhe SHBA-ve nuk ka të bëjë me të ashtuquajturat kritika të një “luftë imperialiste”, sepse ajo nuk kishte në vëmendje dhe si qëllim pushtimin ose aneksimin e ndonjë territori, përkatësisht atë të Kosovës. Për këtë arsye forcat ushtarake të NATO-s dhe SHBA-ve u pritën dhe u mbështetën në territorin e Kosovës me një entuziazëm të jashtëzakonshëm, sepse ato sollën shpresën te banorët vendas për një të ardhme më të mirë në liri e në pavarësi të plotë nga Serbia.³¹ Nëse i përmbahemi parimit të shprehur nga Prof. Sundhaussen, se të pushtuar ose jo të pushtuar nuk mund të quhen territoret, por popujt që i banojnë ato territore, atëherë duhet të pohojmë se banorët e Kosovës për asnjë moment nuk janë ndjerë të tillë, ndaj dhe ata mbështetën pa mëdyshje ndërhyrjen dhe praninë e NATO-s në Kosovë.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë ishte e para ndërhyrje e Aleancës së Atlantikut për zgjidhjen e një konflikti jashtë territorit të vendeve anëtare të saj. Kjo ndërhyrje erdhi në një kohë kur NATO do të festonte 50 vjetorin e krijimit të saj. Prandaj dhe përvoja e re e Kosovës shërbeu si model për hartimin e strategjisë së re të NATO-s, të cilën e miratuan krerët e shteteve dhe të qëverive anëtare të saj, në samitin e Washingtonit më 24 prill 1999. Ajo është quajtur tashmë si strategjia e shekullit XXI, në përmbajtjen e së cilës gjejmë angazhimin e Aleancës së Atlantikut për të dhënë kontributet e saj për ruajtjen e paqes e të sigurisë kudo në botë, veçmas në ato rajone, të cilat rrezikojnë hapësirën euro-atlantike.³² Ngjarjet e Kosovës dhe zgjidhja e krizës së saj shënuan fundin e zingjirit të konflikteve në ish-Jugosllavi. Me Kosovën shtet të pavarur e sovran është konturuar tashmë harta politike e Ballkanit dhe prej këtij momenti për rajonin është hapur një faqe e re në historinë e tij. Kosova e pavarur është njohur prej gjysmës së vendeve të botës (janar 2013), në mesin e të cilave 22 vende të Bashkimit Europian si dhe 25 vende anëtare të NATO-s. Por ende nuk e kanë njohur pesë vende anëtare të Bashkimit Europian

³¹ Kai Lehmann, “Der Luftkrieg der NATO und die deutsche Beteiligung am Eimmarsch in das Kosovo 1999”, in *Wegweiser zur Geschichte - Kosovo*, Herausgegeben vom Militärgeschichtlichen Forschungsamt, 2006, Seite 85.

³² <http://www.nato.int/docu/pr/1999/p99-065d.htm>

si dhe katër vende anëtare të Aleancës së Atlantikut. Kjo ka krijuar probleme në rajon dhe që prej 17 shkurtit 2008, kur u shpall pavarësia, Kosova nuk ka bërë hapa të rëndësishëm drejt integritit euro-atlantik. Njohja e saj prej vendeve europiane është kusht i domozdoshëm për përparimin në fushën e bashkëpunimit dhe integritit të saj. Ndërkaq presioni i Brukselit ndaj vendeve, të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën, ka munguar, duke krijuar vështirësi në vendimmarrjen e tij për ruajtjen e paqes, zbatimin e ligjit e të rendit në këtë vend. Për pasojë EULEX, një mision ky europian për sundimin e ligjit e të rendit në Kosovë, është i çorientuar nga presioni i pesë vendeve anëtare të BE-së. Në kushtet e mosnjohjes prej Greqisë, Spanjës, Rumanisë, Sllovakisë dhe Qipros, Kosova ka hasur pengesa dhe vështirësi në procesin e normalizimit të marrëdhënieve të saj me Serbinë. Ndonëse me të gjithë fqinjët e tjerë të saj (Shqipërinë, Maqedoninë e Malin e Zi) ajo i ka zgjidhur problemet politike e ato që kanë të bëjnë me kufirin, me Serbinë vijon edhe më tej konflikti për veriun e vendit si dhe për vendosjen e një bashkëpunimi të bazuar ne reciprocitetin e të dy vendeve. Serbia e ka shfrytëzuar mosnjohjen e pavarësisë së Kosovës prej vendeve anëtare të BE-së që të intervenojë dhe të krijojë destabilitet në këtë vend. Beogradi i justifikon veprimet e veta kundër Kosovës pikërisht me mosnjohjen e saj nga pesë vende anëtare të Bashkimit Europian.

Kosova e shpalli pavarësinë, duke u mbështetur në rekomandimet e ndërmjetësit ndërkombëtar për zgjidhjen e statusit të saj, Martti Ahtisaari. Sipas planit të Ahtisaarit, Kosova mbetet një vend multi-etnik, me një decentralizim të dukshëm të saj në pikëpamje të ushtrimit të kompetencave nga ana e pushtetit lokal. Ky plan i jep status të veçantë objekteve historike e fetare të Serbisë në Kosovë dhe krijon një kornizë ligjesh, me të cilat favorizohet sidomos pakica serbe. Por është pozitiv fakti që shteti i Kosovës nuk funksionon përmes përdorimit të vetos, siç funksionon p.sh Bosnjë-Hercegovina. Kjo e favorizon stabilitetin dhe e bën Kosovën një vend unitar në pikëpamje të territorit dhe integritetit të saj.³³ Megjithatë në Serbi janë bërë plane për të kërkuar bisedime të reja rreth statusit të Kosovës. Qëllimi është ndarja e saj. Por në kushtet, kur Gjykata Ndërkombëtare e Hagës ka vendosur pro legjitimitetit të shtetit më të ri në Europë si dhe në kushtet kur vendet më të fuqishme e

³³ Enver Bytyçi, *Rikthimi i Martti Ahtisaarit*, Prishtinë: “Faik Konica”, 2008, f. 16.

demokratike të botës e kanë njohur atë, duket e pamundur që procesi të kthehet mbrapsht. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, Turqia, Austria dhe vende të tjera kanë ritheksuar në mënyrë të përsëritur mbështetjen e tyre për tërësinë territoriale të Kosovës. Ndërsa Beogradi insiston për ndarjen e saj. Këtij qëllimi i shërben mbajtja e strukturave paralele në veri të vendit si dhe refuzimi që ato i bëjnë institucioneve të shtetit të Kosovës. Një përpjekje e Prishtinës zyrtare për të vendosur kontrollin në pikat kufitare të veriut të vendit shkaktoi në korrikun e vitit 2011 një reagim të dhunshëm të popullsisë serbe, në ndihmë të të cilave u vunë strukturat e forcave të sigurisë dhe politika në Beograd. Serbët ngritën barrikada dhe bllokuan lëvizjen e lirë në këtë territor. Ata u konfrontuan me forcat e KFOR-it e madje nga reagimi i dhunshëm i tyre u plagosën dhjetra ushtarë të Aleancës. Këto përpjekje të Serbisë për të mbajtur nën tension Kosovën e nën kontroll veriun e saj i japin një dimension të ri situatës. SHBA-të dhe Bashkimi Europian kanë shtuar presionin ndaj Beogradit, që ai të heqë dorë nga destruktiviteti dhe të pranojë realitetin e ri në Kosovë. Për këtë qëllim ata kanë imponuar bisedimet dy palëshe për zgjidhjen e çështjeve praktike. Janë nënshkruar disa marrëveshje, por situata në veri mbetet ende e paqartë.

Lufta e Kosovës dhe pavarësia e saj i kanë dhënë dimension të ri marrëdhënieve e stabilitetit rajonal. Por nëse Kosova ka si sfida të sajën vendosjen e autoritetit të institucioneve dhe të shtetit ligjor në veriun e Mitrovicës, Bosnja dhe Maqedonia kanë më shumë probleme dhe sfida, me të cilat do të duhet të përballohen. Kjo e vështirëson integrimin dhe bashkëpunimin në rajon, më shumë se e pengojnë marrëdhëniet e tensionuara midis Kosovës dhe Serbisë. Destabiliteti që ekziston në Bosnjë, Maqedoni e në Kosovë mundet që ta destabilizojë të gjithë rajonin. Në këto kushte ka mundësi që të ridimensionohen kufijtë, për çka shqiptarët duhet të jenë të përgatitur. Përgatitja do të thotë përpunimi i strategjisë së realizimit të interesave tona kombëtare përmes integritit, në kushtet e respektimit të hartës së sotme gjeopolitike dhe të bashkimit të të gjitha territoreve, në rastin e dezintegritit. Nëse do të veprohet me konceptin e stabilitetit gjeopolitik të tanishëm Kosova ka nevojë të forcojë autoritetin e saj shtetëror, duke ndërtuar një shtet të së drejtës, të lirë e demokratik. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit është e mbetet një nga sfidat kryesore të saj. Pa këtë nuk mund të ndërtohet shteti i së

drejtës. Por ajo ka nevojë të shtrijë sa më parë autoritetin shtetëror në veri të Mitrovicës.

Për të gjitha këto arsye ka mundësi që harta politike e Europës Juglindore të mos ketë marrë formën e saj përfundimtare. Nëse në Bosnjë nuk ndryshohen rregullat e lojës, atëherë vendi do të pësojë një ndryshim të dhunshëm të kufijve. Nëse nuk do të vendoset një pakt politik e social midis shqiptarëve dhe maqedonasve në Maqedoni, atëherë ajo mund të ndahet e shkërmoqet. Nëse ndahet Kosova dhe veriu i saj i bashkëngjitet Serbisë, atëherë është e sigurt se as Bosnjë-Hercegovina dhe as Maqedonia nuk do të jenë më shtete të këtij formati si sot. Madje mundet që të krijohet precedenti i shkëputjes së hungarezëve në veri të Vojvodinës dhe i muslimanëve të Sanxhakut pjesë e territorit të Serbisë, ashtu si edhe shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Për të parandaluar këto akte destabiliteti është e domozdoshme për një kohë të gjatë prania dhe roli i NATO-s në Kosovë e në rajon.

Në politikën ndërkombëtare ndaj Kosovës duket një dualizëm i qëllimtë, i cili synon që të çojë në "lodhjen" e ndërkombëtarëve dhe inspirimin e krijimit të shteteve unitare kombëtare. Kjo do të çonte në bashkimin e serbëve të Bosnjes me shtetin e Serbisë, si dhe shkëputjen e disa qindrave km² në veriun e Kosovës. Por njëkohësisht do të çonte në shpërbërjen e shtetit të Bosnjë-Hercegovinës e atij të Maqedonisë, sepse në Bosnjë kroatët nuk do të pranonin pas serbëve të jetonin nën çatinë e Sarajevës, ndërkohë që shqiptarët në Maqedoni do të refuzonin shtetin e maqedonasve. Në mënyrë të pashmangshme kjo politikë do të çojë në krijimin e një harte të re të Ballkanit. Shqiptarët do të kërkonin bashkimin në një shtet të vetëm, serbët po ashtu, ndërsa hungarezët e Vojvodinës do të kërkonin shkëputje së bashku me muslimanët e Sanxhakut. Në këtë rast kanë të drejtën e shkëputjes edhe hungarezët e Rumanisë e ata të Sllovakisë, muslimanët e Bullgarisë etj. Por a do të përfundonte ky proces pa një konflikt tjetër të armatosur? Logjika dhe përvojat e së kaluarës dëshmojnë se në raste të tilla konfliktet nacionale janë të pashmangshme. Këto konflikte do të kishin karakterin e një lufte tjetër për zgjerimin e territoreve.

Mospranimi i realitetit të sotëm gjeopolitik në rajon është konkretizuar në refuzimin e serbëve të Bosnjës për krijimin e një sistemi politik veprues në këtë vend. Por është shfaqur edhe në veriun e Kosovës, ku Beogradi është involvuar në nxitjen e tensioneve etnike permanente, është evidentuar në Maqedoni, ku maqedonasit provokojnë një konflikt të

hapur me shqiptarët. Ndërkohë që qëndrimet nacionaliste të Greqisë i fryejnë më së shumti këtyre konflikteve dhe vatrave të krizës, Turqia qëndron më e kujdesshme, por e vendosur për të mos lëshuar në interesat e saj në Ballkan. Në këto kushte elita intelektuale, akademike dhe politike shqiptare në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni e kanë për detyrë të programojnë masat reaguese në respektim të vullnetit të shqiptarëve dhe të realizimit të aspiratave që ata kanë. Dilema, nëse do të vijohet një politikë e bashkimit kombëtar të shqiptarëve përmes reformave demokratike dhe integruese në strukturat euro-atlantike; apo do të përshpejtohet procesi i bashkimit nga ndikimi i situatave që imponohen në rajon, do të duhej zgjidhur në favor të interesit tonë nacional. Nëse bashkimi nacional i shqiptarëve në një shtet kombëtar përmes integritimeve është ai që mund të quhet "Plani A", bashkimi i përshpejtuar në një shtet-komb, në kushtet e imponimit të mundshëm, do të kishte të bënte me një "Plan B". Në rastin e parë ne kemi interes për të fituar në kohë, çka është fakultative, në rastin e dytë ka mundësi që të përballemi me një luftë të re, e cila do të kërkonte mobilizim, angazhim, organizim, ndjenjë nacionale shumë të lartë dhe sidomos unifikimin e të gjithë faktorëve në të gjitha territoret ku jetojnë shqiptarët.

S u m m a r y

NATO-S IMPOSING DIPLOMACY IN KOSOVO

The NATO air strikes against ex-Yugoslavia, more specifically against Serbia for the liberation of Kosovo, have raised in the political and academic discourse a debate which still continues nowadays. For the first time after WWII, in the spring of 1999 NATO undertook a military attack against a sovereign state without the approval of the United Nations Security Council. Was this a violation of the international right? Did the political-military Euro-Atlantic alliance have the right to intervene with its army to prevent a human catastrophe and to end the ethnic cleansing in Kosovo? Why did NATO act without the mandate of the Council of Security? What made the critics of the war of Kosovo oppose the air strikes? The focus of this paper is to answer these

questions and to clarify the mist surrounding the issue of the military operations' legitimacy against ex-Yugoslavia (Serbia).

In this paper I will argue in favor of the legitimacy of the NATO military attacks for the liberation of Kosovo. The previous Security Council resolutions had already emphasized that the conflict in Kosovo threatens peace in the region and in Europe, and that the refugee crises risks causing a humanitarian catastrophe. As long as these issues were recognized, the military operations had gained the support of the UN Charter in which it is foreseen the possible intervention in the two above mentioned cases. However, it was simply a lack of political will from the Security Council's members caused by the use of veto from Russia. Diplomacy had already used all the means at its disposal to avoid the conflict in Kosovo, the only option left to resolve the issue was war. The 1244 resolution of the Security Council of 10 June 1999 put Kosovo under international administration and at the same time legitimated the air strikes against ex-Yugoslavia (Serbia). Meanwhile the later developments, namely the independence of Kosovo, brought incredible stability, peace and security to the region. If one compares the region's security before the intervention and after it, you have an additional argument for the legitimacy of the military intervention in Kosovo.

